



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike në Kosovë
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publik dhe Informim
Subjekti: Kuvendi i parë zgjedhor i Forumit Rinor

Prishtinë, 7 tetor 2007

Është Mbajtur Kuvendi i Parë Zgjedhor i Forumit Rinor të AKR-së

Të dielën, në sallën e Kuqe të pallatit të Rinisë në Prishtinë, u mbajt Kuvendi i parë zgjedhor i Forumit Rinor të AKR-së.

Kryetari i Aleancës Kosova e Re, z. Behgjet Pacolli duke ju drejtuar të rinjve të pranishëm, shprehi bindjen e tij se kjo shtresë popullatës së Kosovës është e gatshme për ndryshime, prandaj AKR do të jetë përkrah të rinjve duke ndërtuar së bashku të ardhmen. “Do ta ndërtojmë një Kosovë ndryshe, një Kosovë më të mirë për ne dhe për fëmijët tanë. Tek të rinjtë e Kosovës ka potencial, energji, sinqeritet për punë dhe për ndryshime, prandaj shpreh bindjen se ata do të votojnë ndryshe”, tha lideri Behgjet Pacolli. Ai mbi të gjitha iu bëri thirrje qytetarëve të Kosovës që të dalin masovikisht në votime dhe të votojnë për më të mirin.

Hapjen e punimeve të Kuvendit e bëri zëdhënësi i AKR-së, Arbër Geci, i cili shprehi bindjen se rinia e AKR-së do të dijë të ndërtojë strukturat e saja demokratike duke dëshmuar garë të sinqertë, punë dhe përgjegjësi në ditët që do të vijjnë.

Në vazhdim kuvendi i parë zgjedhor i FR të AKR-së vazhdoi punimet duke zgjedhur kryesinë e punës që përbëhej nga : Kreshnik Sylemani, Fisnik Dobra, Burim Sadiku, Blerton Ajeti dhe Mirsira Halimi.

Kandidat për kryetar të FR të AKR-së ishin : Fisnik Dobra dhe Mentor Ferizi.

Kryetar i FR të AKR-së me shumicë votash u zgjodh Fisnik Dobra nga Prishtina, ndërkaq që për zgjedhjen e Kryesisë ky Kuvend shtyri punimet për të mërkurën në orën 13.00.